



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**THIRRJE PUBLIKE**  
**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTPROPOZIME TË**  
**ORGANIZATAVE JOQEVERITARE DHE INDIVIDËVE, NË FUSHËN:**  
***Organizime.***

Udhëzimet për aplikues

Data e hapjes së thirrjes: më 17.06.2026

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: më 02.07.2026

## PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Prishtinës kujdeset për jetën kulturore të kryeqytetit dhe me këtë synim ofron përkrahje për OJQ dhe individë, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës.

Në këtë vijë, Komuna e Prishtinës synon pasurimin e jetës kulturore të qytetit, rritjen e llojllojshmërisë së aktiviteteve, tërheqjen e numrit sa më të madh të publikut në aktivitete, tërheqjen e turistëve në këto aktivitete të krijuara, si dhe në promovimin e kulturës dhe aktiviteteve të gjithë qytetarëve.

### OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objekti/objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë, që Komuna e Prishtinës të ofrojë përkrahje për *individë dhe OJQ*, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

#### Objektivat specifike të thirrjes janë:

- Të fuqizohen krijuesit e pavarur dhe krijuesit e rinj që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
- Të prodhohen punë të reja kulturore/artistike;
- Të ketë shtrirje të gjerë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në jetën kulturore/artistike në Komunën e Prishtinës;
- Të sigurohet mbështetje për institucionet e pavarura kulturore që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
- Të mbështetet puna në grupe dhe bashkëpunimi ndër-disiplinar dhe ndër sektorial;
- Të përkrahën punë me përmbajtje kritike, të cilat synojnë të sfidojnë pabarazi sociale dhe ekonomike;
- Të përkrahën punë me përmbajtje Feministe;
- Të stimulohet inovacioni teknologjik në të gjitha fushat kulturore/artistike;
- Të inkurajohen personat me nevoja të veçanta për pjesëmarrje dhe prodhim në sektorin e artistik dhe kulturor.

## VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE SHUMA E PËRGJITHSHME E THIRRJES

- Vlera e planifikuar për këtë thirrje është **40,000.00 €**.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është 500€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **19,000.00 €**.
- Afati për dorëzimin e propozimeve është nga data **17.06.2026 deri më 02.07.2026**.
- Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muajit dhjetor 2026*.

## MËNYRA E APLIKIMIT, PËRSHKRIMI I FUSHAVE, KUSHTET FORMALE DHE KRITERET QË DUHET PLOTESUAR APLIKANTËT

### MËNYRA E APLIKIMIT

- Aplikimi bëhet përgjatë thirrjes së hapur, përmes mënyrës elektronike online <http://krs.prishtinaonline.com/>.

### PËRSHKRIMI I FUSHAVE

Përshkrim i fushave në të cilat aplikanti mund ta parashikoje zbatimin e programeve apo projekteve përgjatë aplikimit:

- a. **Organizim:** performancë, trajnim, punëtori, debat, tryezë, ligjeratë, simpozium dhe konferencë;

## KRITERET QË DUHET TË I PLOTËSOJNË APLIKANTËT

### **Kriteret e përgjithshme**

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës, apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal, sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, dhe
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

## LISTA E DOKUMENTEVE TË DETYRUSHME TË THIRRJES PUBLIKE

- **Aplikacioni online;**
- **Për individ:**
  - Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës;
  - Vërtetimi/ konfirmimi i llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
  - Certifikata e vendbanimit (merret në zyrat e gjendjes civile apo në bashkësi lokale);
  - Deklaratë për financimin e dyfishhtë.

- **Për OJQ-të:**

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës së përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimin që OJQ nuk kanë obligime tatimore (nga ATK);
- Deklaratë për financimin e dyfishtë.

**Lista e dokumenteve specifike të thirrjes publike sipas kategorive:**

**1. Organizime**

- a. Link i punëve të mëhershme të aplikuesëve;
- b. Biografi të shkurtër për ekipet e përfshira në projekt;
- c. Koncepti i programit artistik (Përshkrim i detajuar ).
- d. Sinopsis ( aty ku është e zbatueshme).

**KUSHTET FORMALE TË THIRRJES**

**Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike, mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit, do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

**Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:**

- Blerja e pajisjeve për zyra;
- Renovime të objekteve;
- Dhurata, mirënjohje dhe shpërblime të ngjashme.

- Shërbime administrative (pagesa e qerasë, derivate, ujit, rrymës, telefonit, internetit, mirëmbajtja e llogarisë bankare)

#### **Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:**

- Aktivitete që nuk zhvillohen në komunën e Prishtinës;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
- Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar.

#### PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT

- Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muajit dhjetor, 2026.*

#### DORËZIMI I APLIKACIONIT

- Aplikacionin mund ta dorëzoni vetëm përmes mënyrës elektronike, online <http://krs.prishtinaonline.com/>,
- Aplikacionet në formë tjetër nuk pranohen.
- Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [kultura.pr@rks-gov.net](mailto:kultura.pr@rks-gov.net), Pyetjet mund të bëhet deri më **26.06.2026**.
- Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më **02.07.2026, ora 23:59h**, përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>
- Për ndihmë shtesë lidhur me mënyrën e aplikimit ju lutem klikoni në vegzën <https://www.youtube.com/watch?v=yZeaoKdi4E>